| STATUTI<br>I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR<br>**"AGRIS ALBANIA" Sh.p.k.** | BYLAWS<br>OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY<br>**"AGRIS ALBANIA" Sh.p.k** |
|---|---|
| **KAPITULLI I**<br>**EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA** | **CHAPTER I**<br>**NAME, FORM OF THE COMPANY, LEGAL SEAT, OBJECT, DURATION** |
| **Neni 1**<br>**Themelimi** | **Article 1**<br>**Incorporation** |
| 1.1 Emri i shoqërisë është **"AGRIS ALBANIA" Sh.p.k.**(këtu më poshtë e quajtur "**Shoqëria**"). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar. | 1.1 The company is named "**AGRIS ALBANIA" Sh.p.k**. (hereinafter referred to as the "**Company**"). The Company is incorporated in the form of the limited liability company, in accordance with the Albanian law. |
| 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit. | 1.2 The Company acquires legal personality upon registration with the National Business Center. |
| 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar dhe Statutin. | 1.3 The Company shall exercise the activity in accordance with the provisions of the Albanian laws and the Bylaws. |
| **Neni 2**<br>**Selia** | **Article 2**<br>**Legal Seat** |
| 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Ndërtesa Ambasador 3, Rruga "Dervish Hima", kati i 20-të, Zyra 159, Tiranë, Shqipëri". | 2.1 The legal seat of the Company is located at the address: Ambassador 3 Building, Dervish Hima Street, 20th floor, Office 159, Tirana, Albania. |
| 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin. | 2.2 The Company may establish branches, and/or representative offices within the territory of the Republic of Albania and/or in other countries, in accordance with the applicable laws and the Bylaws. |
| **Neni 3**<br>**Objekti** | **Article 3**<br>**Object** |

| | |
|---|---|
| 3.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të jetë si më poshtë:<br>i. Prodhimi, paketimi, import-eksport, tregtimi (shitje me shumicë dhe pakicë) të farave ( të çfarëdo lloji); fidanëve ( të çfarëdo lloji); fertilizues; mallra dhe produkte agrokimike; fruta dhe perime të freskëta; drithëra; lëndë e parë për përdorim të përgjithshëm në bujqësi.<br>ii. Shërbime dhe aktivitete mbështetëse për prodhimin e të korrave. | 3.1 The main object of the Company shall be the following:<br>i. Production, packaging, import-export, trading (wholesale and retail sales) of seeds (any kind); seedlings (any kind); fertilizers; agrochemical goods and products; fresh fruits and vegetables; cereals; agricultural raw materials in general.<br>ii. Services and support activities for crop production. |
| 3.2 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve. | 3.2 Activities which are subject to prior permits and/or approvals shall be carried out only after such permits and/or approvals are obtained. |
| **Neni 4**<br>**<u>Kohëzgjatja</u>** | **Article 4**<br>**<u>Duration</u>** |
| 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar. | 4.1 The duration of the Company shall be for an indefinite period of time. |
| **KAPITULLI II**<br>**KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT** | **CHAPTER II**<br>**SHARE CAPITAL, CONTRIBUTIONS, QUOTA-SHARES** |
| **Neni 5**<br>**<u>Kapitali Themeltar dhe Ortaku i Vetëm</u>** | **Article 5**<br>**<u>Initial Share Capital and the Sole Shareholder</u>** |
| 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 50.000,00(pesëdhjetë mijë) Euro, i ndarë në 1 (një) kuotë. | 5.1 The initial share capital of the Company is Euro 50.000,00 (fifty thousand), divided in 1 (one) quota share. |
| 5.2 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë zotërues i 1 (një) kuote, të barabartë me 50.000,00(pesëdhjetë mijë) Euro që përfaqëson 100% të kapitalit është:<br>- **AGRIS S.A**, një shoqëri aksionare, e | 5.2 The Sole Shareholder of the Company, holder of one quota share of 100 ALL constituting 100% of the share capital is:<br>- **AGRIS S.A,** a joint stock company |

themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj sipas legjislacionit të Greqisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar me numër 20872826000, me seli në adresën: Klidi, Imathia, 590 32 Greqi, zotërues i një kuote me vlerë 50.000,00 Euro, që përfaqëson 100% të kapitalit.

5.3 Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku i Vetëm brenda 1 muaji nga themelimi i Shoqërisë.

5.4 Përgjegjësia e Ortakut të Vetëm shtrihet deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**KAPITULLI III**

**ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË**

**Neni 6**

**<u>Ortaku i Vetëm</u>**

6.1 Ortaku i Vetëm është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.

6.2 Ortaku i Vetëm ka funksionet e mëposhtme:

- Përcakton politikat tregtare dhe ekonomike të Shoqërisë dhe mbikëqyr zbatimin e këtyre të fundit nga administratori/ët;
- Emëron dhe shkarkon administratorin/ët;
- Emëron dhe shkarkon ekspertin (et) kontabël dhe/ose likuiduesin (t) e Shoqërisë;
- Përcakton shpërblimin e administratorit/ëve, ekspertit/ëve kontabël dhe likuiduesit/ve;
- Miraton pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së

organized and existing under the laws of Greece, under registration No.20872826000, with legal seat at the address: Klidi, Imathia, P.O. Box 590 32 Greece, holder of one quota, equal to Euro 50.000,00 representing 100% of the share capital.

5.3 The share capital of the Company will entirely be paid by the Sole Shareholder within one month upon establishment of the Company.

5.4 The liability of the Sole Shareholder is extended only up to the amount of the contribution in the share capital.

**CHAPTER III**

**GOVERNING BODIES OF THE COMPANY**

**Article 6**

**<u>The Sole Shareholder</u>**

6.1 The Sole Shareholder represents the highest decision-making body of the Company.

6.2 The Sole Shareholder has the following powers:

- Determines the commercial and business policies of the Company and supervises their implementation by the administrator(s);
- Appoints and dismisses the administrator(s);
- Appoints and dismisses the auditor(s) and/or liquidator(s) of the Company;
- Determines the remuneration for the administrator(s), auditor(s) and liquidator(s);
- Approves the annual financial statement and the performance

veprimtarisë të përgatitura nga administratori/ët;

- Merr vendim për ndryshimet e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit;
- Merr vendim për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- Merr vendim për shpërndarjen e fitimeve, dividendëve;
- Merr vendim për ristrukturimin e Shoqërisë ose prishjen e saj;
- Merr vendim për çdo çështje tjetër të parashikuar nga ligji.

**Neni 7**

**<u>Regjistri i Vendimeve</u>**

7.1 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen. Regjistri i Vendimeve do të mbahet nga Shoqëria, dhe çdo regjistrim do të nënshkruhet nga administratori/ët.

**Neni 8**

**<u>Administratori</u>**

8.1 Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator, i emëruar me vendim të Ortakut të Vetëm.

8.2 Administratori i Shoqërisë është:
**Z.** Ioannis Karakolis, lindur më 04.04.2019, në Selanik dhe banues në adresën: "Kalvou 3, Pilaia, Selanik" mbajtës i pasaportës me nr. AN2838401.

8.3 Mandati i administratorit është për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh, i rinovueshëm, dhe, nëse është rasti, vazhdon deri në vendimin e ardhshëm të Ortakut të Vetëm që do të marrë vendim

reports prepared by the administrator(s);

- Resolves on amendments of these Bylaws and of the Articles of Incorporation;
- Resolves on the increase or decrease of the share capital of the Company;
- Resolves on the distribution of profits, dividends;
- Resolves on the restructuring of the Company or its dissolution;
- Resolves on any other issue stipulated by the law.

**Article 7**

**<u>Register of Decisions</u>**

7.1 All decisions taken by the Sole Shareholder shall be registered to the Register of Decisions, the data of which may not be changed or otherwise altered. The Register of Decisions shall be kept by the Company, and each registration shall be signed by the administrator(s).

**<u>Article 8</u>**

**<u>Administrator</u>**

8.1 The Company is managed by 1 (one) Administrator, appointed by virtue of decision of the Sole Shareholder.

8.2 The administrator of the Company is:
Mr. Ioannis Karakolis Greek citizen, born on 04.04.1991, in Thessaloniki and resident at the address: Kalvou 3 Pilaia Thessaloniki, holder of Passport no. AN2838401.

8.3 The mandate of the administrator is for a period of 5 (five) years, renewable,

në lidhje me rinovimin e mandatit të tij apo emërimin e administratorit të ri.

8.4 Shoqëria përfaqësohet ndaj të tretëve nga Administratori.

8.5 Administratori ka kompetencat e mëposhtme:

Përveçse kur parashikohet ndryshe me vendimin përkatës të Ortakut të Vetëm për emërimin e administratorit, administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:

- Administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë duke zbatuar politikat tregtare dhe ekonomike të përcaktuara nga Asambleja e Ortakëve;
- Përfaqësimin e Shoqërisë në marrëdhënie me çdo palë të tretë;
- Marrjen e masave për hartimin dhe mbajtjen në mënyrën e duhur të pasqyrave financiare dhe të dokumenteve;
- Përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave financiare vjetore dhe bilanceve të konsoliduara, përgatitjen e raportit të ecurisë dhe dorëzimin e këtyre të fundit bashkë me propozimin përkatës për shpërndarjen e fitimeve Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Krijimi e sistemit të paralajmërimit në lidhje me rrethanat, të cilat kërcënojnë veprimtarinë e Shoqërisë;
- Dorëzimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dokumenteve dhe të dhënave të Shoqërisë, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe;
- Raportimin tek Asambleja e Ortakëve

and it may be extended up to the forthcoming decision of the Sole Shareholder resolving on the renewal of its mandate or the appointment of the new administrator.

8.4 The Company is represented towards third parties by the administrator.

8.5 The Administrator has the following powers:

Unless otherwise stipulated by a relevant decision of the Sole Shareholders appointing the administrator(s), the administrator(s) shall have the following powers and obligations:

- Management of the Company's business by implementing the commercial and business policies defined by the General Meeting of the Shareholders;
- Representation of the Company towards any third parties.
- Ensuring that the necessary financial books and documents are duly prepared and kept;
- Preparation and signing of the annual financial statements and consolidated accounts, performance report and their submission to the General Meeting of the Shareholders for approval together with the proposals for the distribution of profits;
- Provision of early warning systems with respect to developments threatening the business of the Company;
- Submission of the Company's data and documents to the National



- në lidhje me zbatimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe në lidhje me përmbushjen e transaksioneve të një rëndësie të veçantë për ecurinë e Shoqërisë;
- Kryerjen e çdo detyre tjetër të parashikuar nga ligji ose nga ky Statut.

8.6 Administratori mund të autorizojë palë të tretë të përfaqësojë Shoqërinë dhe të nënshkruajë çdo dokument, kërkesë ose aplikim në emër dhe për llogari të Shoqërisë;

8.7 Administratori është përgjegjës ndaj Shoqërisë për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara nga dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacioni në fuqi.

**KAPITULLI IV**

**VITI FINANCIAR – SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

**Neni 9**

**Viti Financiar**

9.1 Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.

9.2 Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2019.

**Neni 10**

**Shpërndarja e Fitimeve**

10.1 Pas miratimit të pasqyrave vjetore

Registration Centre, if not otherwise stipulated by law;
- Reporting to the General Meeting of the Shareholders on the implementation of business policies and on the completion of transactions of particular importance for the Company's performance;
- Execution of any other duty stipulated by the law or these Bylaws.

8.6 The Administrator may authorize by virtue of a power of attorney any third party to represent the Company and sign any document, requests or applications in the name and on behalf of the Company;

8.7 The Administrator is liable towards the Company for damages caused by breach of any of the articles of these Bylaws or the law.

**CHAPTER IV**

**FINANCIAL YEAR - DISTRIBUTION OF PROFITS**

**Article 9**

**Financial Year**

9.1 The financial year commences on January $1^{st}$ and ends on December $31^{st}$, of each calendar year. At the end of the financial year the administrator prepares the annual financial statements of the Company, in accordance with the laws in force.

9.2 Exceptionally, the first financial year commences upon the registration of the Company with the National Registration Centre and ends on the December 31st, 2019.

| | |
|---|---|
| financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Ortaku i Vetëm vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të këtyre të fundit. | **Article 10**<br>**<u>Distribution of Profits</u>** |
| **KAPITULLI V**<br>**DISPOZITA PËRFUNDIMTARE** | 10.1 After the approval of the annual financial statements, the Sole Shareholder decides on the distribution of profits, if any. |
| **Neni 11**<br>**<u>Ligji i Zbatueshëm</u>** | **CHAPTER V**<br>**FINAL PROVISIONS** |
| 11.1 Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare. | **Article 11**<br>**<u>Applicable Law</u>** |
| **Neni 12**<br>**<u>Të ndryshme</u>** | 11.1 All matters which are not regulated by these Bylaws shall be governed by the relevant provisions of the Albanian law governing commercial companies. |
| 12.1 Ky Statut është nënshkruar në 4 (katër) kopje origjinale në shqip dhe anglisht me të njëjtën vlerë secila. | **Article 12**<br>**<u>Miscellaneous</u>** |
| **<u>ORTAKU I VETËM</u>**<br><br>**Për AGRIS S.A**<br><br>**Z. George Karakolis**<br><br>________________ | 12.1 These Bylaws are signed in 4 (four) originals in English and Albanian language with the same value each. |
| | **<u>THE SOLE SHAREHOLDER</u>**<br><br>**For AGRIS S.A**<br><br>**Mr. George Karakolis**<br><br>________________ |
| Tiranë më 21.10.2019 | Tirana 21.10.2019 |